



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legislacioni.gov.al

Nr. 116

Datë 30 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 64/2014 datë 26.6.2014	Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë	5139
Vendim i Kuvendit nr. 51/2014 datë 24.7.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8633, datë 18.7.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”	5148
Udhëzim i MBZHRAU nr. 12, datë 15.7.2014	Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t’u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore.....	5148
Urdhër i MZHETS nr. 305, datë 30.5.2014	Për procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut	5150
Urdhër i MBZHRAU nr. 350, datë 15.7.2014	Për miratimin e rregullores “Për laktoproteinat e caktuara, kazeinat dhe kazeinatet, të destinuara për konsum njerëzor”	5158
	Vendim <i>i shkurtuar</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Rudin Arapi	5160

LIGJ
Nr. 64/2014

PËR PUSHTETET DHE AUTORITETET E DREJTIMIT E TË KOMANDIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 169, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i pushteteve dhe autoriteteve të drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) përcaktimin e pushteteve e të kufizimeve të tyre, të autoriteteve, përgjegjësive, roleve dhe funksioneve të institucioneve dhe organeve të përfshira në sigurimin e mbrojtjes kombëtare të Republikës së Shqipërisë;

b) zbatimin e parimit demokratik të kontrollit dhe drejtimit civil mbi Forcat e Armatosura;

c) përcaktimin e përgjegjësisë strategjike dhe operacionale për drejtimin e komandimit e Forcave të Armatosura në kohë paqeje ose në rastet kur vendosen masa të jashtëzakonshme;

ç) paraqitjen e qartë të zinxhirit të drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura në kohë paqeje ose në rastet kur vendosen masa të jashtëzakonshme.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për fushën e veprimtarisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë pushtetet dhe autoritetet e përmendura në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 5
Juridiksioni territorial

Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj për ushtarakët shqiptarë, kur ata janë dërguar me mision, shërbim, studime, stërvitje të përbashkët, mision diplomatik ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 6
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Pushtet” është zotërimi i së drejtës së drejtimit dhe komandimit, me qëllim realizimin e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura.

2. “Autoritet” është institucioni që gëzon të drejtën e ushtrimit të pushtetit të dhënë me ligj.

3. “Komandim” është pushteti që i jepet një ushtaraku për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e një force ushtarake, si dhe procesi, nëpërmjet të cilit një komandant imponon vullnetin e tij dhe përçon synimet e veta te vartësit, me qëllim që të realizojë një veprim të caktuar.

4. “Drejtim” është përdorimi i ligjshëm i burimeve njerëzore e materiale dhe i procedurave për planifikimin, kontrollin dhe koordinimin e këtyre burimeve për përmbushjen e misioneve dhe detyrave të dhëna.

5. “Drejtim dhe komandim” është procesi, nëpërmjet të cilit drejtuesit civilë dhe komandantët ushtarakë identifikojnë, planifikojnë dhe arrijnë objektivat strategjike, operacionale dhe taktike, duke ushtruar autoritet dhe drejtim mbi burimet njerëzore e materiale.

6. “Komandant” është ushtaraku komandues, i cili ka pushtetin ligjor për të ushtruar drejtimin dhe komandimin e personelit të Forcave të Armatosura që ka në varësi.

7. “Autoritet i komandimit” është e drejta e ligjshme e dhënë me anë të emërimit një pozicioni komandimi për të organizuar dhe përdorur forcat, në përmbushje të misioneve të dhëna.

8. “Drejtim operacionale” është pushteti dhe përgjegjësia që ushtrohet nga një autoritet ushtarak për drejtimin dhe kontrollin e forcave të dhëna, për përmbushjen e misioneve dhe detyrave të veçanta.

9. “Operacion” është veprimi ushtarak ose kryerja e një misioni ushtarak strategjik, taktik, shërbimi, stërvitor ose administrativ, si dhe procesi i kryerjes së luftimit, duke përfshirë lëvizjen, furnizimin, sulmin, mbrojtjen dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo beteje ose fushe.

10. “Planet e veprimit” janë plane të natyrës strategjike, operacionale, taktike, ose të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore e materiale dhe që nënkuptojnë një dokument të shkruar që përvijon kryerjen e misioneve, qëllimet dhe objektivat e caktuar, burimet njerëzore e materiale të kërkuara dhe afatet për kryerjen e tyre.

11. “Planet specifike të veprimit” përfshijnë planet e përbashkëta operacionale për operacionet ushtarake që synojnë përmbushjen e objektivave strategjikë dhe operacionale, brenda një territori dhe periudhe të dhënë kohe.

12. “Planet e luftës” janë plane të natyrës strategjike, operacionale ose taktike dhe që përfshijnë të gjitha misionet, qëllimet dhe objektivat e caktuar, përshkrimin e detyrave e të burimeve njerëzore e materiale, të kërkuara për ekzekutimin e operacioneve nga Forcat e Armatosura, në kohë lufte.

13. “Urdhër” është një akt që komunikohet me shkrim, me gojë, në mënyrë elektronike ose nëpërmjet sinjaleve dhe që ka natyrë detyruese.

14. “Forcë”, në varësi të kontekstit të përdorur, nënkupton:

- a) totalin e të gjitha reparteve ushtarake;
- b) secilën prej forcave tokësore, detare dhe ajrore;
- c) një njësi ushtarake të pajisur, të përgatitur dhe të gatshme për të përdorur forcën.

15. “Forcat e Armatosura” janë forca tokësore, detare, ajrore, strukturat mbështetëse, Shtabi i Përgjithshëm bashkë me strukturat e varësisë, si dhe strukturat ushtarake të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes.

16. “Komandë” është komanda e forcës tokësore, detare dhe ajrore dhe komandat e strukturave mbështetëse.

17. “Strukturë mbështetëse” është njësi ushtarake në nivel komande ose brigade, sipas përcaktimeve të bëra në strukturën e Forcave të Armatosura, të miratuar nga autoriteti përgjegjës.

18. “Njësi ushtarake rezervë”, është strukturë e Forcave të Armatosura, e organizuar dhe e kompletuar me armatim, pajisje, teknikë, infrastrukturë dhe një minimum personeli aktiv për trajnim dhe mirëmbajtje, e cila aktivizohet dhe kompletohet me personel rezervist sipas nevojës.

19. “Direktiva e mbrojtjes” është dokumenti, me anë të të cilit ministri i Mbrojtjes jep udhëzime për Forcat e Armatosura lidhur me politikat, çështjet dhe objektivat e sigurisë kombëtare, prioritetin e misioneve ushtarake, prioritetin e projekteve në vazhdim për modernizimin e mbrojtjes dhe nivelet e pritshme të burimeve të planifikuara për një periudhë të dhënë planifikimi.

KREU II

HIERARKIA E PUSHTETEVE DHE AUTORITETEVE TË DREJTIMIT E TË KOMANDIMIT STRATEGJIK NË FORCAT E ARMATOSURA

Neni 7

Pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit strategjik

Hierarkia e autoriteteve të drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është si më poshtë:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
2. Presidenti i Republikës;
3. Këshilli i Ministrave;
4. Kryeministri;
5. Ministri i Mbrojtjes;
6. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
7. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
8. komandantët e forcave tokësore, detare e ajrore;
9. komandantët e strukturave mbështetëse;
10. Komandanti i Forcave të Armatosura në kohë lufte.

Neni 8

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është autoriteti më i lartë në hierarkinë e pushteteve dhe autoriteteve të drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) miraton me ligj Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë;

b) ushtron kontroll parlamentar për çështje që kanë lidhje me veprimtarinë e Forcave të Armatosura;

c) vendos, sipas legjislacionit në fuqi, për bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar;

ç) kur nuk është përcaktuar ndryshe në një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, përcakton statusin ligjor të forcave të huaja ushtarake që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) miraton, me propozim të Këshillit të Ministrave, planet afatgjata të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura;

dh) miraton numrin limit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

e) vendos për aktivizimin, mobilizimin, vënien në dispozicion të burimeve njerëzore dhe materiale për përdorim nga Forcat e Armatosura në kushtet e masave të jashtëzakonshme.

Neni 9

Presidenti i Republikës

1. Presidenti i Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ushtron pushtetin e dhënë nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi.

2. Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, e ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura.

3. Presidenti i Republikës, si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ushtron këto kompetenca:

a) jep gradat madhore, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes;

b) emëron, gradon, shkarkon dhe nxjerr në rezervë ose në lirim, me propozimin e Kryeministrit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

c) emëron dhe shkarkon, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore;

ç) jep dekorata dhe tituj nderi sipas legjislacionit në fuqi;

d) urdhëron vendosjen e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura, në kushtet e masave të jashtëzakonshme;

dh) vendos për mobilizimin dhe për provat e gatishmërisë së njësisë ushtarake rezervë;

e) miraton regjimin, rregullat e gatishmërisë luftarake dhe ngritjen në kushtim të Forcave të Armatosura;

ë) u jep njësisë ushtarake, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, flamujt luftarakë;

4. Presidenti i Republikës i rekomandon Këshillit të Ministrave masa, në varësi të nevojave për:

a) përballimin e rreziqeve që i kanosen Republikës së Shqipërisë ose përballimin e gjendjes së luftës;

b) krijimin e njësisë të reja ushtarake në Forcat e Armatosura;

c) programe të veçanta për zhvillimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura.

5. Në rastet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij neni, Presidenti i Republikës shprehet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së propozimeve, duke miratuar ose refuzuar propozimin.

Neni 10

Këshilli i Sigurimit Kombëtar

1. Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor, i cili mbështet Presidentin e Republikës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisë kushtetuese e ligjore.

2. Këshilli i Sigurimit Kombëtar kryesohet nga Presidenti i Republikës dhe thirret prej tij sa herë që e gjykon të nevojshme e sipas një rendi dite të përcaktuar.

3. Anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit Kombëtar janë:

- a) Kryetari i Kuvendit;
- b) Kryeministri;
- c) Ministri i Mbrojtjes;
- ç) Ministri Punëve të Jashtme;
- d) Ministri i Drejtësisë;
- dh) ministri përgjegjës për punët e brendshme;
- e) ministri përgjegjës për financat;
- ë) ministri përgjegjës për transportin;
- f) ministri përgjegjës për energjinë;
- g) kryetari i komisionit të përhershëm parlamentar përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes;
- gj) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

h) Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit.

i) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

4. Në raste të veçanta, Presidenti i Republikës mund të ftojë pjesëmarrës të tjerë.

5. Në rast se anëtarët e Këshillit të Sigurimit Kombëtar për arsye objektive nuk mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, ata autorizojnë zëvendësit e tyre, duke marrë miratimin paraprak të Presidentit.

6. Këshilli i Sigurimit Kombëtar diskuton dhe jep mendime për çështje të sigurisë, të mbrojtjes, të armë-kontrollit dhe për çdo çështje tjetër në fushën e sigurisë kombëtare.

7. Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk merr vendime.

8. Mbledhjet e tij zhvillohen të mbyllura.

Neni 11

Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) përgatit dhe i paraqet për miratim Kuvendit Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë;

b) i propozon Kuvendit ndryshime në numrin limit të personelit të Forcave të Armatosura;

c) miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, planin e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit, gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme;

ç) përcakton pagat dhe trajtimin ekonomik të personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura;

d) përcakton afatet e shërbimit dhe të përdorimit të armatimit, municioneve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, rregullat, procedurat dhe përgjegjësitë për heqjen nga armatimi e përdorimi, si dhe trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi e përdorimi;

dh) organizon dhe drejton mbrojtjen civile të Republikës së Shqipërisë dhe vendos krijimin e funksionimit e shtabeve të mbrojtjes pranë qarqeve;

e) miraton programe të veçanta për pajisjen dhe modernizimin e Forcave të Armatosura;

ë) miraton modelet e uniformave ushtarake, gradave, simboleve, flamujve dhe çdo shenje tjetër dalluese të uniformës ushtarake;

f) miraton normat e trajtimit me uniformë të ushtarakëve;

g) miraton normat e trajtimit me ushqim të ushtarakëve;

gj) miraton rezervat materiale në Forcat e Armatosura, si dhe përcakton rregullat për krijimin, shkallëzimin, mënyrën e administrimit e të përdorimit të tyre për kohë paqeje dhe të gjendjeve, për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme;

h) përcakton detyrimet e institucioneve dhe subjekteve publike e private për mbajtjen e rezervave të

materialeve e të mallrave në interes të mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për situata të veçanta;

i) miraton listën e aerodromeve civile, që mund të caktohen si aeroporte rezervë të Forcave të Armatosura gjatë gjendjeve, për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme.

Neni 12 Kryeministri

Kryeministri ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) i propozon Presidentit të Republikës emërimin, gradimin, shkarkimin dhe nxjerrjen në rezervë ose lirim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm;

b) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore, përveç atyre të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji;

c) komandon në një detyrë tjetër, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, për një periudhë kohe jo më shumë se 6 muaj, oficerët aktivë me grada madhore, me përjashtim të komandantëve të forcave;

ç) nxjerr në rezervë ose lirim, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore, me përjashtim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

d) miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, planin e vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura në kohë paqeje;

dh) miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, strukturën organizative të Forcave të Armatosura;

e) miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, strukturën organizative dhe organikën analitike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

ë) miraton, listën e aerodromeve ushtarake, që mund të caktohen si aeroporte rezervë të aviacionit civil;

f) bashkërendon punën ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të tjera për lajmërimin e popullsisë për rreziqet e fatkeqësisë natyrore, të aksidentit teknologjik dhe për rreziqet e luftës.

Neni 13 Ministri i Mbrojtjes

1. Ministri i Mbrojtjes është person civil, i cili, nën përgjegjësinë e tij dhe brenda drejtimeve kryesore të politikës shtetërore, drejton veprimtarinë e Forcave të Armatosura në përmbushjen e misionit të tyre kushtetues.

2. Ministri i Mbrojtjes ka këto detyra e përgjegjësi:

a) paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave projektin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë dhe projektakte të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe Forcat e Armatosura;

b) paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave planet afatgjatë të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura dhe programet e veçanta në fushën e

mbrojtjes, që kërkojnë mbështetje financiare;

c) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në takimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështje të fushës së mbrojtjes. Ministri i Mbrojtjes mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar për të marrë pjesë në vend të tij;

ç) përgjigjet për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe frytshmëri;

d) miraton, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, tabelat e organizimit dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave të varësisë së saj;

dh) i paraqet për miratim Kryeministrit, sipas propozimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, strukturën organizative dhe organikën analitike të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

e) emëron, liron ose shkarkon nga detyra përfaqësuesit ushtarakë të Republikës së Shqipërisë në shtabet dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, si dhe atashetë ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

ë) propozon te ministri përgjegjës për punët e jashtme akreditimin e atashëve ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

f) nxjerr urdhra dhe udhëzime për Forcat e Armatosura, në zbatim të kompetencave të tij;

g) miraton direktivën e mbrojtjes;

gj) jep titullin "oficer aktiv" dhe gradën e parë për oficerët, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura;

h) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, nxjerr në rezervë apo lirim, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, oficerët aktivë të Forcave të Armatosura, me përjashtim të oficerëve me grada madhore;

i) gradon, me propozimin e komisioneve të karrierës, oficerët aktivë të Forcave të Armatosura, deri në gradën kolonel;

j) komandon në një detyrë tjetër oficerët aktivë të Forcave të Armatosura, për një periudhë kohe jo më shumë se 6 muaj, me përjashtim të oficerëve me grada madhore;

k) i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, modelet e uniformave ushtarake, gradave, simboleve, flamujve dhe çdo shenje tjetër dalluese të uniformës ushtarake;

l) i paraqet për miratim Presidentit të Republikës, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, njësitë e Forcave të Armatosura, të cilat do të mbajnë flamuj luftarakë;

ll) jep medalje, sipas legjisllacionit në fuqi;

m) i propozon Presidentit të Republikës dhënien e dekoratave dhe titujve të nderit për personelin ushtarak e civil të Forcave të Armatosura, sipas legjislacionit në fuqi;

n) delegon autoritetin e drejtimit operacional, ushtar-grup-skuadër-togë-kompani-batalion dhe të strukturave të njësuara me to në forcën ajrore dhe forcën detare të komandat aleate, me të cilat Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryejnë misione të përbashkëta;

nj) miraton politika, udhëzime e procedura standarde për menaxhimin e personelit në Forcat e Armatosura;

o) jep, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, simbolet apo shenjat, që mbajnë njësitë ushtarake, si dhe përcakton rregullat e dhënies së tyre;

p) miraton, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, normat e materialeve të mirëmbajtjes së armëve, të teknikës dhe të pajisjeve, normat e karburant-lubrikantëve, të teknikës dhe pajisjeve, kompletin e ushtarakut, normat e përdorimit të materialeve inventar reparti dhe të materialeve të konsumit në Forcat e Armatosura;

q) emërton, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, objektet ushtarake;

r) miraton politika në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë në Forcat e Armatosura;

rr) emëron, liron ose shkarkon nga detyra personelin civil në Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe strukturat e varësisë së tyre, përveç atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil apo që janë në funksione ushtari ose nënoficeri;

s) urdhëron pjesëmarrjen e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitje ushtarake ndërkombëtare, jep lejen për qëndrim të përkohshëm të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jep lejen për transitim të forcave ushtarake të huaja nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ministri i Mbrojtjes mund të delegojë te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, si dhe te komandantët e forcave apo strukturave mbështetëse kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjat "h", "i" dhe "rr", të pikës 2, të këtij neni.

4. Ministri i Mbrojtjes zëvendësohet nga zëvendësministri i Mbrojtjes në kryerjen e detyrave, në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar ose për shkak të një pengese ligjore që has gjatë veprimtarisë së tij.

5. Ministri i Mbrojtjes, përveç detyrave të përcaktuara në këtë ligj, ushtron edhe detyra të tjera, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 14

Këshilli i Politikave të Mbrojtjes

1. Pranë Ministrisë të Mbrojtjes krijohet Këshilli i Politikave të Mbrojtjes si organ këshillimor, i cili

mbështet Ministrin e Mbrojtjes në ushtrimin e kompetencave dhe të përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore.

2. Këshilli i Politikave të Mbrojtjes kryesohet nga Ministri i Mbrojtjes dhe thirret prej tij sa herë që e gjykon të nevojshme.

3. Anëtarët e përhershëm të Këshillit të Politikave të Mbrojtjes janë:

a) Zëvendësministri i Mbrojtjes;

b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

c) Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

ç) Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes;

d) komandantët e forcave;

dh) komandantët e strukturave mbështetëse.

4. Në raste të veçanta Ministri i Mbrojtjes mund të ftojë pjesëmarrës të tjerë.

5. Funksionimi i këtij këshilli përcaktohet me urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes.

6. Këshilli i Politikave të Mbrojtjes nuk merr vendime.

Neni 15

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

1. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përgjigjet përpara Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Ministrisë të Mbrojtjes për drejtimin e veprimtarisë së Forcave të Armatosura.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është autoriteti më i lartë ushtarak në gradë dhe në hierarkinë e drejtimit e të komandimit strategjik në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përzgjidhet nga radhët e oficerëve me grada madhore të Forcave të Armatosura, në bazë të aftësive profesionale dhe të përvojës.

4. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me marrjen e detyrës, bën betimin para Presidentit të Republikës.

5. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura shërben për një periudhë prej tre vjetësh, me të drejtë riemërimi vetëm për një mandat tjetër.

6. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura lirohet nga detyra kur:

a) plotëson afatin e qëndrimit në detyrë;

b) jep dorëheqjen;

c) plotëson kushtet për të dalë në pension;

ç) është në paaftësi fizike apo mendore për ushtrimin e detyrave të tij për një periudhë mbi 6 muaj.

7. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura shkarkohet nga detyra dhe del në lirim kur:

a) shkel Kushtetutën ose kryen shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) kryen akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e ushtarakut të Forcave të Armatosura.

8. Në rastet e lirimit nga detyra, sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 6, të këtij neni, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përfiton trajtim të veçantë. Kriteret dhe masa e këtij trajtimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

9. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura drejton Shtabin e Përgjithshëm dhe ka këto detyra e përgjegjësi:

a) i propozon Ministrit të Mbrojtjes planet e zhvillimit dhe të modernizimit të Forcave të Armatosura dhe programet e veçanta në fushën e mbrojtjes, që kërkojnë mbështetje financiare;

b) miraton doktrinën e përbashkët ushtarake të Forcave të Armatosura, si dhe doktrinën e forcave tokësore, detare, ajrore dhe të strukturave mbështetëse;

c) miraton planet e veprimeve të njëjësive ushtarake të Forcave të Armatosura në kohë paqeje;

ç) miraton planet për arsimimin dhe kualifikimin e personelit të Forcave të Armatosura, në përputhje me politikën dhe procedurat e nxjerra nga Ministri i Mbrojtjes;

d) kontrollon gatishmërinë luftarake dhe merr masa për përmirësimin e saj;

dh) bën aktivizimin e Forcave të Armatosura kur kjo gjë urdhërohet nga autoriteti i përcaktuar me ligj;

e) planifikon rekrutimin dhe menaxhimin e personelit të Forcave të Armatosura, në përputhje me politikën, udhëzimet dhe procedurat standarde për menaxhimin e personelit të Forcave të Armatosura, të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes;

ë) organizon dhe realizon kryerjen e komunikimit për komandimin dhe kontrollin e Forcave të Armatosura;

f) organizon kryerjen e vrojtimit, të kontrollit dhe sigurisë së paprekshmërisë së hapësirës territoriale të Republikës së Shqipërisë;

g) orienton veprimtarinë e strukturave të zbulimit në Forcat e Armatosura, nëpërmjet miratimit të procedurave dhe standardeve, si dhe monitoron e kontrollon përmbushjen e nevojave për mbështetje me zbulim të Forcave të Armatosura;

gj) siguron mbështetjen logjistike për Forcat e Armatosura;

h) organizon punën për parandalimin, zbulimin dhe dokumentimin e veprimtarive kriminale në Forcat e Armatosura;

i) realizon bashkëpunimin me Forcat e Armatosura të vendeve të tjera, në përputhje me planin e Ministrisë së Mbrojtjes;

j) zhvillon sistemet e komandimit, të kontrollit, të komunikimit dhe të njoftimit të të dhënave në Forcat e Armatosura dhe të infrastrukturave ushtarake;

k) përfaqëson Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në organizmat ushtarakë ndërkombëtarë;

l) planifikon zhvillimin profesional të oficerëve dhe nënoficerëve të Forcave të Armatosura;

ll) titullon nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura dhe jep gradën e parë të nënoficerit, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura;

m) titullon ushtarët aktivë të Forcave të Armatosura dhe jep gradën e parë të ushtarit, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura;

n) emëron, liron ose shkarkon nga detyra ushtarët dhe nënoficerët aktivë, si dhe personelin civil të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e të strukturave të varësisë së tij, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose që janë në funksione oficeri;

nj) nxjerr në rezervë ose lirim ushtarët dhe nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura;

o) gradon, me propozimin e komisioneve të karrierës, nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura;

p) gradon ushtarët aktivë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturave të varësisë së tyre;

q) komandon në një detyrë tjetër nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura, për një periudhë kohe jo më shumë se 6 muaj;

r) miraton kalimin në emërtesë të personelit nënoficer dhe ushtar;

rr) jep medalje apo certifikata, sipas legjislacionit në fuqi;

s) drejton përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, siguron plotësimin me personel, si dhe merr drejtimin e organizimit e veprimeve ushtarake dhe joushtarake;

sh) nxjerr urdhra dhe udhëzime brenda përgjegjësisë dhe detyrave që ka;

t) kontrollon që sistemi i vlerësimit të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të jetë në përputhje me politikën, udhëzimet e procedurat standarde, të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

10. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura mund të delegojë tek organet vartëse ushtarake kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjat “ll”, “m”, “n” dhe “nj”, të pikës 9, të këtij neni.

11. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura zëvendësohet nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në kryerjen e detyrave në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar ose për shkak të një pengese ligjore që has gjatë veprimtarisë së tij.

12. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, përveç detyrave të përcaktuara në këtë ligj, ushtron edhe detyra të tjera, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 16

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

1. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura përbën strukturën organizative më të lartë ushtarake në Forcat e Armatosura.

2. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura organizohet dhe funksionon si shtab i bashkuar me përfaqësues të forcave tokësore, detare dhe ajrore.

3. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në kohë lufte vepron si shtab për Presidentin e Republikës dhe Komandantin e Forcave të Armatosura.

4. Shtabi i Përgjithshëm përgjigjet për:

a) planifikimin dhe rekrutimin e personelit ushtarak në Forcat e Armatosura;

b) përgatitjen dhe stërvitjen e përbashkët të të tria forcave dhe strukturave mbështetëse;

c) vlerësimin strategjik të kërcënimeve, rreziqeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre;

ç) përgatitjen e planeve për mbështetjen logjistike;

d) planifikimin, bashkërendimin e punës dhe mbështetjen shëndetësore të efektivave të Forcave të Armatosura në kohë paqeje dhe në operacionet luftarake dhe joluftarake brenda dhe jashtë vendit;

dh) bashkëpunimin me autoritetet civile dhe organizatat qeveritare e joqeveritare në interes të realizimit të misionit të Forcave të Armatosura;

e) programimin e misioneve, operacioneve, trajnimeve dhe stërvitjeve;

ë) zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ndërveprimin dhe bashkërendimin e punës për stërvitjet e përbashkëta me NATO-n dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë;

f) hartimin e kërkesave për pajisjen dhe modernizimin e Forcave të Armatosura;

g) zhvillimin e sistemeve të komandimit, kontrollit, komunikimit dhe informimit në Forcat e Armatosura;

gj) zhvillimin e koncepteve dhe doktrinae, planifikimin, organizimin, mbështetjen me burime, zhvillimin dhe modernizimin, përgatitjen, stërvitjen dhe gatishmërinë operacionale të Forcave të Armatosura;

h) planifikimin dhe ndjekjen e arsimimit, kualifikimit dhe ecurisë në karrierë të personelit ushtarak, në përputhje me ligjin për gradat dhe karrierën dhe politikat e menaxhimit të personelit në Forcat e Armatosura;

i) përgatitjen për miratim tek autoritetet vendimmarrëse të strukturës organizative e të planit të vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura;

j) përgatitjen për miratim tek autoritetet vendimmarrëse të tabelave të organizimit dhe të pajisjeve të strukturave ushtarake;

k) përgatitjen e planit të përdorimit të Forcave të Armatosura për operacione brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, duke përfshirë operacionet që kryhen në bazë të nenit V, të Traktatit të NATO-s, apo detyrimeve të tjera ndërkombëtare;

l) përgatitjen e planit të mobilizimit të burimeve njerëzore dhe atyre materiale të vendit;

ll) përgatitjen për miratim tek autoritetet vendimmarrëse të modeleve të uniformave ushtarake, gradave, simboleve, flamujve dhe çdo shenje tjetër dalluese të uniformës ushtarake;

m) përgatitjen për miratim tek autoritetet vendimmarrëse të normave të materialeve të mirëmbajtjes së armëve, të teknikës e të pajisjeve, normave të karburant-lubrifikantëve, të teknikës e të pajisjeve, kompletit të ushtarakut, të normave të përdorimit të materialeve inventar reparti dhe të materialeve të konsumit në Forcat e Armatosura.

Neni 17

Forcat tokësore, detare dhe ajrore

Forcat tokësore, detare dhe ajrore përbëjnë komponentët operacionale tokësore, detare dhe ajrore për mbrojtjen ushtarake të vendit.

Neni 18

Komandanti i forcës dhe strukturës mbështetëse

1. Komandimi dhe drejtimi i drejtpërdrejtë i forcave dhe strukturave mbështetëse realizohet nga komandanti përkatës.

2. Komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse përgjigjet për gjendjen, përgatitjen, mobilizimin, gatishmërinë luftarake, drejtimin operacional, zhvillimin e doktrinës, të operacioneve, të planifikimit, të programimit, të pajisjes e të modernizimit, si dhe për menaxhimin e burimeve njerëzore të forcës apo strukturës mbështetëse që drejton.

3. Komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse raporton drejtpërdrejt te Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

4. Komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse i paraqet për miratim Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura:

a) doktrinën e forcës apo të strukturës që drejton;

b) planet afatgjata dhe programet vjetore për forcën që drejton;

c) planet dhe programet vjetore e afatmesme të zhvillimit e të modernizimit për forcën që drejton;

ç) projektet për strukturën e forcës që drejton;

d) programet e përgatitjes dhe ato të kualifikimit të personelit, brenda dhe jashtë vendit;

dh) të dhëna për plotësimin me personel të strukturës që drejton;

e) planin për arsimim e kualifikim të personelit për forcën që drejton.

5. Komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse ka këto përgjegjësi:

a) miraton manualët e luftimit dhe të teknikës për forcën që drejton;

b) paraqet kërkesat buxhetore dhe ndjek zbatimin e buxhetit, sipas akteve ligjore e nënligjore të menaxhimit të sistemit buxhetor;

c) siguron që sistemi i vlerësimit të ushtarakëve aktivë në forcën apo strukturën mbështetëse që drejton të zbatohet në përputhje me politikën, udhëzimet e procedurat standarde, të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes;

ç) emëron, liron ose shkarkon nga detyra ushtarët dhe nënoficerët aktivë, si dhe personelin civil të forcës apo strukturës mbështetëse që drejton, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose që janë në funksione oficeri;

d) gradon ushtarët aktivë të forcës apo strukturës mbështetëse që drejton;

dh) jep medalje apo certifikata, sipas legjislacionit në fuqi;

e) planizon dhe kryen operacione luftarake dhe joluftarake;

ë) siguron nivelin e kërkuar të gatishmërisë dhe përgatitjes luftarake;

f) siguron kapacitetet dhe gatishmërinë e nevojshme për realizimin e misionit të ngarkuar;

g) monitoron dhe vëzhgon hapësirën territoriale, me qëllim paralajmërimin në kohë të kërcënimeve dhe rreziqeve me kapacitetet e veta apo në bashkëpunim me NATO-n dhe vendet e tjera partnere;

gj) përgatit stërvitjet e përbashkëta me forcat e tjera, në nivel operacional, për përballimin e kërcënimeve apo rreziqeve që kërcënojnë sigurinë e vendit;

h) nxjerr urdhra dhe udhëzime të karakterit ushtarak dhe administrativ brenda kompetencave të tij.

6. Komandanti i strukturës mbështetëse, përveç detyrave të përcaktuara në pikën 5, të këtij neni, ka dhe këto përgjegjësi:

a) siguron mbështetjen me shërbime të Forcave të Armatosura;

b) mbështet Forcat e Armatosura në fushën e stërvitjes, arsimimit, standardizimit dhe zhvillimit të doktrinës;

c) organizon dhe drejton programet profesionale të arsimimit ushtarak, stërvitjes ushtarake bazë dhe kurseve për zhvillimin e aftësive ushtarake për Forcat e Armatosura;

ç) përgatit doktrinën e përbashkët dhe konceptet e stërvitjes së avancuar për të mbështetur stërvitjen dhe përgatitjen e Forcave të Armatosura.

7. Përveç detyrave të përcaktuara në këtë ligj, komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse ushtron edhe detyra të tjera, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

8. Komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse zëvendësohet nga zëvendëskomandanti në kryerjen e detyrave në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar ose për shkak të një pengese ligjore që has gjatë veprimtarisë së tij.

Neni 19

Detyrat dhe përgjegjësitë e komandantëve të strukturave të tjera

Detyrat dhe përgjegjësitë e komandantëve, në nivel më të ulët se përcaktimet e këtij ligji, përcaktohen me rregullore të veçantë, të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

KREU III

FORCAT E ARMATOSURA NË KUSHTET E MASAVE TË JASHTËZAKONSHME

Neni 20

Përdorimi i Forcave të Armatosura gjatë gjendjes së luftës

1. Gjendja e luftës shpallet me ligj nga Kuvendi ose me dekret të Presidentit të Republikës, sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Autoritetet që shpallin gjendjen e luftës, shpallin me të njëjtën procedurë dhe vendosjen e paqes.

3. Gjendja e luftës apo vendosja e paqes njoftohet nga të gjitha mjetet e informimit të publikut.

4. Në aktin e shpalljes së gjendjes së luftës përcaktohen qartë të drejtat dhe liritë themelore që kufizohen, në përputhje me nenin 175 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

5. Me shpalljen e gjendjes së luftës apo me vendosjen e paqes, Kuvendi vendos, sipas rastit, gjendjen e mobilizimit apo të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

6. Pas shpalljes së gjendjes së luftës, Forcat e Armatosura fillojnë ekzekutimin e planeve të luftës për mbrojtjen kombëtare.

7. Presidenti i Republikës, si Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, gjatë gjendjes së luftës bashkëpunon me Këshillin e Ministrave dhe Kryeministrin për operacionet ushtarake.

Neni 21

Komandanti i Forcave të Armatosura

1. Komandanti i Forcave të Armatosura është eprori ushtarak më i lartë në gjendje lufte dhe përgjigjet para Presidentit të Republikës dhe Kryeministrin për drejtimin e Forcave të Armatosura.

2. Komandant i Forcave të Armatosura emërohet në kohë lufte nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryeministrin, një nga oficerët aktivë me grada madhore.

3. Emërimi dhe shkarkimi bëhen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryeministrin.

4. Komandanti i Forcave të Armatosura ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) ndjek dhe zbaton masat e gatishmërisë për mbrojtjen e vendit gjatë gjendjes së luftës;

b) ndjek dhe realizon kalimin e formacioneve të Forcave të Armatosura nga organizimi i kohës së paqes në atë të luftës;

c) informon Presidentin e Republikës periodikisht për gjendjen dhe situatën në vend;

ç) urdhëron kufizimin e lëvizjes së lirë, për aq kohë sa është e nevojshme, të qytetarëve në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) ndjek dhe mbikëqyr zbatimin dhe respektimin e ligjit të luftës në Forcat e Armatosura, si dhe përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e vartësve të tij për zbatimin e këtij ligji;

dh) organizon bashkëveprimin me autoritetet civile në rastet kur është në interes të operacioneve luftarake dhe përcakton kompetencat për këtë bashkëpunim duke vendosur prioritetet;

e) në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra që janë të detyrueshëm për zbatim si për autoritetet ushtarake, ashtu dhe për ato civile.

5. Vendimet e Komandantit të Forcave të Armatosura për përdorimin e Forcave të Armatosura në veprimet ushtarake në kohë lufte miratohen nga Presidenti i Republikës.

Neni 22

Përdorimi i Forcave të Armatosura gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

1. Gjendja e jashtëzakonshme vendoset me ligj nga Kuvendi, sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme, Forcat e Armatosura, me vendim të Kuvendit, pas kërkesës së Këshillit të Ministrave, mund të ndërhyjnë për rivendosjen e rendit, vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje ta kryejnë këtë detyrë.

3. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme Kryeministri është drejtpërdrejt përgjegjës për drejtimin e Forcave të Armatosura, përmes hierarkisë së drejtimit e të komandimit.

4. Pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme Kryeministri i raporton Kuvendit për përdorimin e Forcave të Armatosura gjatë kësaj periudhe.

5. Veprimet, që ndërmerren nga Forcat e Armatosura gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të funksionimit normal të shtetit.

Neni 23

Përdorimi i Forcave të Armatosura gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore

1. Gjendja e fatkeqësisë natyrore vendoset nga Këshilli i Ministrave, sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Me vendosjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Forcat e Armatosura, me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të ndërhyjnë për eliminimin e pasojave të ardhura nga fatkeqësia natyrore apo aksidenti teknologjik.

3. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore Kryeministri është drejtpërdrejt përgjegjës për drejtimin e Forcave të Armatosura, përmes hierarkisë së drejtimit e të komandimit.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të nenit 11, si dhe të pikës 8, të nenit 15, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të nenit 12, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “d”, “g”, “nj”, “o”, “p”, “q”, “r” dhe “rr”, të pikës 2, të nenit 13, si dhe pikës 5, të nenit 14, të këtij ligji.

Neni 25

Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 26

Shfuqizime

Ligji nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2014

KRYETARI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 51/2014

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 8633, DATË 18.7.2014, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, "PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 64/2014, "PËR PUSHTETET DHE AUTORITETET E DREJTIMIT E TË KOMANDIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 8633, datë 18.7.2014, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 24.7.2014

UDHËZIM
Nr. 12, datë 15.7.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË SIGURISË DHE CILËSISË SË MIELLIT TË GRURIT TË PARAPAKETUAR, PËR T'U SHITUR TE KONSUMATORI I FUNDIT OSE PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË TJERA USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 23 pika 2 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. A. Udhëzimi të zbatohet për miellin e grurit për konsum njerëzor të përgatitur nga gruri i zakonshëm, *Triticum aestivum*, *Triticum vulgare* ose grurë i species *Triticum compactum Host* ose nga përzierja e tyre, e cila parapaketohet për shitje për konsumatorin e fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore.

B. Udhëzimi të mos zbatohet:

a) Për çdo produkt që përgatitet nga grurë i fortë, *Triticum durum Desf*, vetëm ose i kombinuar me grurë tjetër;

b) Për miell integral, miell të afërt me atë integral ose *semolina* (grimca endosperme pas pasurimit që

shkojnë për bluarje) nga grurë i zakonshëm, *Triticum aestivum L*, ose grurë i species *Triticum compactum Host* ose përzierjet e tyre;

c) Për miell që përdoret si shtesë në industrinë e birrës ose për prodhimin e amidonit ose glutenit;

d) Për miell gruri që nuk përdoret në industrinë ushqimore;

e) Për miellrat që kanë përbajtur të ulët proteine ose që pas procesit të blojës kanë nevojë për trajtim special, përveç tharjes ose zbardhimit dhe/ose të cilët janë shtuar përbërës që nuk përfshihen në pikat 3.b.ii dhe 4.

2. Mielli i grurit është produkt i përgatitur nga grurë i zakonshëm, *Triticum aestivum L*, ose grurë i zakonshëm, *Triticum compactum Host* ose përzierjet e tyre, me anë të copëtimit ose proceseve të bluarjes, në të cilën janë hequr pjesërisht cipa dhe embrioni dhe mbetja bluhet në një shkallë të përshtatshme imtësie.

3. Mielli i grurit duhet të plotësojë treguesit cilësorë të mëposhtëm:

a) Të përgjithshëm:

i) Mielli i grurit dhe çdo përbërës që shtohet duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për konsum njerëzor;

ii) Mielli i grurit duhet të jetë pa erë dhe shije jonormale dhe pa insekte të gjalla;

iii) Mielli i grurit duhet të jetë pa papastërti me origjinë shtazore (duke përfshirë dhe insektet e ngordhura) në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut.

b) Specifike:

i) Përbajtja e lagështisë 15.5% masë/masë maks;

Kufijtë më të ulët të lagështisë duhet të kërkohen për destinacione të caktuara në lidhje me klimën, kohën e transportit dhe të ruajtjes;

ii) Përbërësit e mëposhtëm mund të shtohen në miellin e grurit në sasi të nevojshme për qëllime teknologjike:

- Produkte të maltuara me aktivitet enzimatik të prodhuara nga gruri, elbi ose thekra;

- Gluten vital gruri;

- Miell soje dhe miell leguminozesh.

4. Niveli maksimal në produktin përfundimtar të enzimave dhe agjentëve përpunues të miellit, përcaktohet në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Mielli i grurit duhet të jetë pa metale të rënda në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut. Ato duhet të jenë në përputhje me nivelet e vendosura në udhëzimin nr. 13, datë 29.9.2010, "Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore".

6. Mielli i grurit nuk duhet të ketë mbetje pesticidesh më shumë se vlera maksimale e lejuar për këtë produkt e vendosur në udhëzimin nr. 5, datë 14.5.2014, "Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në banane, domate, grurë, kastravecë, mollë, patate, rrush tavoline, rrush për verë, speca, ullinj tavoline".

7. Mielli i grurit nuk duhet të ketë mykotoksina më shumë se vlera maksimale e lejuar për këtë produkt në përcaktimet e udhëzimit nr. 13, datë 29.9.2010, “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.

8. Mielli i grurit duhet të plotësojë kushtet higjienike, të vendosura si më poshtë:

a) Mielli i grurit duhet të jetë pa lëndë të huaja në shkallën që zbatohet procesi optimal teknologjik;

b) Sipas metodave të caktuara të marrjes së mostrës dhe analizimit, mielli i grurit:

i) Duhet të jetë pa mikroorganizma në sasi, të cilat janë të dëmshme për shëndetin e njeriut;

ii) Duhet të jetë pa parazitë, të cilët janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut;

iii) Nuk duhet të përmbajë asnjë substancë me origjinë nga mikroorganizma në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut.

9. Mielli i grurit pakëtohet në ambalazhe, të cilat sigurojnë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit.

10. Ambalazhet duhet të jenë të sigurta dhe të përshtatshme për qëllimin e përdorimit. Ato nuk duhet të mbartin asnjë substancë toksike dhe nuk duhet të kenë shije dhe erë të padëshirueshme për produktin. Kur produkti është paketuar në thasë, ato duhet të jenë të pastër, të fortë, të qepur shumë mirë ose të ngjitur mirë.

11. Mielli i grurit etiketohet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullores “Për

etiketimin e produkteve ushqimore”. Gjithashtu, për etiketimin e tij zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

a) Emri i produktit në etiketë duhet të jetë “miell gruri”;

b) Informacioni për ambalazhet që shiten me shumicë do të jepet ose në ambalazh ose në dokumentet shoqëruese. Emri i produktit, numri i identifikimit të lot-it, si dhe emri dhe adresa e stabilimentit prodhues apo paketues duhet të vendosen mbi ambalazh. Numri i identifikimit të lot-it, si dhe emri dhe adresa e stabilimentit prodhues apo paketues mund të vendosen me anë të një marke identifikimi, me kusht që një markë e tillë të jetë identike me atë të dokumenteve shoqëruese.

12. Marrja e mostrave dhe analizimi, bëhet në përputhje me rregulloren nr. 220, datë 21.5.1999, “Mbi procedurat e marrjes së mostrave dhe kryerjes së analizave të produkteve ushqimore”, dhe shtojcën 2, “Kufiri i lejuar dhe metoda e analizimit për disa tregues të miellit të grurit”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

13. Ngarkohen Drejtorja e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA I

NIVELI MAKSIMAL NË PRODUKTIN PËRFUNDIMTAR TË ENZIMAVE DHE AGJENTËVE PËRPUNUES TË MIELLIT

Aditivi ushqimor	Niveli maksimal në produktin përfundimtar
Enzimat	
Amilaza nga myqet <i>Aspergillus niger</i>	GMP
Amilaza nga myqet <i>Aspergillus oryzae</i>	GMP
Enzime proteolitike nga <i>Bacillus subtilis</i>	GMP
Enzime proteolitike nga <i>Bacillus oryzae</i>	GMP
Agjentë përpunues të miellit	
L-acid askorbik dhe kripërat e tij të natriumit dhe kaliumit	300 mg/kg
L-cisteine klorhidrat	90 mg/kg
Dioksid squfuri (vetëm në miellrat për prodhim biskotash dhe pastiçerie)	200 mg/kg
Mono-kalcium fosfat	2500 mg/kg
Lecitine	2000 mg/kg
Klor në miellrat e keqeve që përmbajnë më shumë sheqer se miell	2500 mg/kg
Dioksid klori për produkte furre që fryhen me maja	30 mg/kg
Benzoil peroksid	60 mg/kg
Azodikarbonamid për bukët e fermentuara (e ardhura)	45 mg/kg

SHTOJCA II
KUFIRI I LEJUAR DHE METODA E ANALIZIMIT PËR DISA TREGUES TË MIELLIT TË GRURIT

Treguesi/përshkrimi	Kufiri i lejuar	Metoda e analizës
Hiri	Preferenca e blerësit	AOAC 92303 bot.18 ISO 2171:1980 ICC Metoda nr.104/1(1990)
Aciditeti i yndyrës	Maksimumi 70 mg/100 g miell mbi bazën e lëndës së thatë, e shprehur si acid sulfurik. Ose Jo më shumë se 50 mg hidroksid kaliumi për 100 g miell mbi bazën e lëndës së thatë.	ISO 7305:1986 Ose AOAC 939,05 bot.18
Proteina (Nx5,7)	Minimumi 12.5% mbi bazën e peshës së thatë.	ICC 105/1 Metoda për përcaktimin e proteinës bruto në drithëra dhe produkte drithërash për ushqim dhe për ushqim për kafshët (metodë e tipit I) katalizator selenium/bakër.
Ushqyesit: - vitaminat; - komponimet minerale; - aminoacidet.	Konform legjislacionit shqiptar në fuqi.	Konform legjislacionit shqiptar në fuqi.
Madhësia e grimcave (granulometria)	98% ose më shumë e miellit duhet të kalojë përmes hapësirës 212 mikron (sita nr.70)	AOAC 965,22 bot.18

URDHËR
Nr. 305, datë 30.5.2014

PËR PROCEDURAT STANDARDE
OPERACIONALE TË VEPRIMTARISË SË
MBIKËQYRJES SË TREGUT, TË DETYRUESHME
PËR TË GJITHA STRUKTURAT E MBIKËQYRJES
SË TREGUT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 10480, datë 17.11.2012, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", i ndryshuar, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

URDHËRON:

1. Përcaktimin e procedurave standarde operationale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj

PROCEDURAT STANDARDE OPERACIONALE
TË VEPRIMTARISË SË MBIKËQYRJES SË
TREGUT TË DETYRUESHME PËR TË GJITHA
STRUKTURAT E MBIKËQYRJES SË TREGUT

I. Fusha e veprimit dhe përkufizimi i termave

1. Ky urdhër është i detyrueshëm për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligjin e posaçëm.

2. Në këtë urdhër, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Ligji i mbikëqyrjes së tregut" është ligji nr. 10489, datë 15.12.2012, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

b) "Ligji i sigurisë së përgjithshme" është ligji nr. 10480, datë 17.11.2012, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

c) "Ligji i inspektimit" është ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

3. Termat e tjerë, të përdorur në këtë urdhër kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 10480, datë 17.11.2012, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 10489, datë 15.12.2012, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar.

II. Qëllimi dhe parimet e mbikëqyrjes të tregut

4. Qëllimi i veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut është parandalimi i shfaqjes së rreziqeve të produkteve joushqimore në shëndetin, jetën, mjedisin apo interesa të tjera publike.

5. Veprimtaria e strukturave mbikëqyrëse të tregut, udhëhiqet nga parimi i parandalimit dhe parimi i proporcionalitetit.

6. Sipas parimit të parandalimit, masat e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, synojnë parandalimin e shfaqjes së rreziqeve të produkteve.

7. Sipas parimit të proporcionalitetit, veprimtaria e mbikëqyrjes së tregut është proporcionale në:

- a) mënyrën e kryerjes të veprimeve të mbikëqyrjes;
- b) në përcaktimin e masave, për parandalimin e rrezikut;
- c) në përcaktimin e sanksioneve për operatorët ekonomikë përgjegjës.

8. Proporcionaliteti në kryerjen e veprimtarisë.

Në kryerjen e veprimtarisë, inspektori i strukturës së mbikëqyrjes së tregut, vepron në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e operatorit ekonomik, subjekt i inspektimit, vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit.

9. Proporcionaliteti në marrjen e masave.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr ato masa që janë:

- a) të nevojshme për shmangien e rreziqeve;
- b) të përshtatshme për të arritur në mënyrë efektive këtë shmangie; dhe
- c) që shmangin rreziqet me sa më pak kosto për operatorët ekonomikë të përfshirë.

10. Proporcionaliteti në përcaktimin e dënimeve.

Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori i mbikëqyrjes së tregut, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion që është i nevojshëm për arritjen e qëllimit të dënimit dhe që ndërsa e arrin këtë qëllim në mënyra efektive, cenon sa më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të operatorit ekonomik.

III. Objekti i mbikëqyrjes së tregut

11. Struktura e mbikëqyrjes së tregut, brenda fushës të saj të kompetencës, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të inspektojnë, çdo produkt:

- a) që është shitur, shitet apo ofrohet për shitje ose çdo konsumim apo përdorim për konsumatorët;
- b) që është në zotërim ose nën kontrollin e një prodhuesi a shpërndarësi ose është i depozituar apo i shpërndarë te ndonjë person për qëllime të shitjes ose të përgatitjes për shitje, kudo që produkti të gjendet.
- c) çdo produkt/instalim të vënë në shërbim/në përdorim për të tretët apo publikun e gjerë, për të cilin zbatohen rregullat dhe kërkesat e sigurisë në shërbim /përdorim, kudo që produkti gjendet.

12. Struktura e mbikëqyrjes së tregut, për produktet /grup-produktet në kompetencën e saj, ka gjithashtu të drejtën dhe përgjegjësinë për inspektimin, të:

- a) Respektimit nga prodhuesi (fabrikuesi i produktit, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi i produktit dhe

shpërndarësi) të detyrimeve përkatëse sipas ligjit për sigurinë e përgjithshme.

b) Respektimit nga operatorët ekonomikë (prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit, importuesi dhe /apo shpërndarësi) të detyrimeve përkatëse sipas ligjit për mbikëqyrjen e tregut dhe sipas ligjit për sigurinë e përgjithshme.

c) Respektimit nga personi përgjegjës për produktin /instalimin në shërbim të detyrimeve ligjore sipas ligjit të mbikëqyrjes të tregut.

IV. Programi dhe autorizimi i inspektimeve të mbikëqyrjes të tregut.

13. Programi dhe autorizimi i inspektimeve të mbikëqyrjes të tregut, kryhet në përputhje me ligjin për inspektimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

14. Programimi i veprimtarisë të mbikëqyrjes të tregut bazohet mbi vlerësimin e riskut.

V. Paraqitja për inspektim dhe identifikimi i inspektorit dhe personave ndihmës gjatë veprimeve të inspektimit

15. Inspektori/inspektorët e mbikëqyrjes së tregut (këtej e tutje "Inspektori"), përpara fillimit të veprimeve konkrete të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për objektin e inspektimit e për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

16. Inspektori detyrohet që, nëse është e nevojshme, të informojë në çdo hap përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

17. Inspektori i mbikëqyrjes së tregut, gjatë gjithë kohës së inspektimit mban në një vend të dukshëm "kartën e inspektorit" të lëshuar nga Inspektorati Qendror për inspektorët shtetërorë apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore për inspektoratet vendore.

18. Sipas përcaktimit të autorizimit të inspektimit, në veprimtarinë e inspektimit mund të jenë prezent edhe persona të tjerë të përcaktuar shprehimisht në autorizimin e inspektimit. Personat e tjerë identifikohen dhe mbajnë në vend të dukshëm kartën e ndihmësit të lëshuar nga titullari i strukturës së mbikëqyrës së tregut.

VI. Metodologjia e mbikëqyrjes së tregut

19. Inspektori, për çdo produkt objekt inspektimi mund të kryejë këta tipa kontrolli:

- a) kontroll dokumentar;
- b) kontroll fizik tregues;
- c) kontroll laboratorik.

20. Kontrolli dokumentar synon verifikimin e dokumentacionit teknik të produktit (disenjimin dhe ndërtimin e produktit) dhe dokumentacionit shoqërues të tij.

21. Kontrolli i dokumentacionit teknik të produktit përfshin, por pa u kufizuar, verifikimin e:

a) Deklaratës të konformitetit, për produktet për të cilat ka rregulla teknike të miratuara;

b) Dokumentacionit teknik për ndërtimin e produktit;

c) Raportet e testeve apo dokumente të tjera që vlerësojnë konformitetin e produktit;

22. Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “b” dhe “c” të paragrafit 21 më sipër, verifikohet nëse është i disponueshëm tek operatori subjekt inspektimi. Nëse konsiderohet e nevojshme inspektori kërkon paraqitjen e tij brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar prej tij.

23. Kontrolli i dokumentacionit shoqëruet përfshin, por pa u kufizuar, verifikimin e:

a) udhëzimeve të përdorimit të produktit;

b) udhëzimeve të mirëmbajtjes së produktit (nëse janë të zbatueshme).

24. Kontrolli, sipas paragrafit 23, përfshin verifikimin e ekzistencës së tyre, përkthimit në gjuhën shqipe, si dhe qartësisë dhe plotësisë së tyre.

25. Kontrolli i dokumentacioni teknik, veçanërisht i deklaratës së konformitetit, është tregues i rëndësishëm për sigurinë e produktit: kur ai mungon, është i gabuar apo është kontradiktor (i referohet standardeve apo rregullave të pazbatueshme etj.) ka gjasa që produkti të mos jetë i sigurt.

26. Kontroll fizik tregues synon verifikim sipas listë-kontrollit përkatës të elementeve thelbësore të kontrollit sipas produktit/kategorisë së produktit. Listë-kontrollat për produkt apo grup-produkte hartohen dhe miratohen në bazë të parashikimeve në kreun XVIII të këtij urdhri.

27. Kontrolli fizik përfshin edhe kryerjen e testeve (provave) të thjeshta në vend, lidhur me elementet thelbësore të kontrollit të produktit. Këto lloj testesh kanë vetëm vlerë orientuese, domethënë, ato shërbejnë për të krijuar apo jo dyshimin që produkti ka mangësi dhe ato duhen interpretuar së bashku me gjetjet e tjera gjatë inspektimit.

28. Inspektori, vendos kryerjen e një “vlerësimi paraprak të riskut” dhe shtrirjen e mëtejshme të hetimit administrativ, nëse nga kontrolli dokumentar dhe kontrolli fizik:

a) Krijohet dyshimi i arsyeshëm se produkti nuk përmbush kërkesat ligjore/kërkesat e përgjithshme të sigurisë të zbatueshme për të, apo megjithëse produkti mund t'i përmbushë kërkesat ligjore/kërkesat e përgjithshme të sigurisë, ai mund të jetë i rrezikshëm;

b) Konstatohen, mangësi të qarta dhe të dukshme lidhur me elementet thelbësore të kontrollit.

29. Vlerësimi paraprak i riskut kryhet sipas procedurës të parashikuar në seksionin XX të këtij urdhri.

30. Shtrirja e hetimit administrativ përfshin marrjen e mostrave dhe kontrollin laboratorik të tyre dhe/apo kërkimin e informacionit dhe dokumentacionit shtesë mbi sigurinë e produktit.

31. Marrja dhe trajtimi i mostrave kryhet sipas procedurave të parashikuara në seksionin XIX të këtij urdhri.

VII. Masat urgjente

32. Inspektori mund të marrë, me vendim të ndërmjetëm, masat urgjente të parashikuara në këtë seksion dhe çdo masë tjetër proporcionalë që ka për qëllim parandalimin apo minimizimin e një risku.

33. Masat urgjente mund të merren në çdo moment gjatë inspektimit deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar. Regjimi juridik i tyre përcaktohet sipas ligjit për inspektimin.

34. Në rast dyshimi të arsyeshëm, kur një produkt paraqet një risk të ulët apo mesatar, inspektori vendos masën e ndalimit të furnizimit, ofrimit apo ekspozimit të produkteve apo grup-produkteve.

35. Në rast dyshimi të arsyeshëm, që një produkt paraqet një risk të lartë apo serioz, inspektori vendos masën e ndalimit të përkohshëm të tregtimit (të bërjes të disponueshëm në treg).

36. Në rastet kur konkludohet, gjatë inspektimit apo hetimit, që produkti, dukshëm (jashtë çdo dyshimi) paraqet një risk mesatar, të lartë apo serioz, inspektori vendos masën e ndalimit të përkohshëm të tregtimit (të bërjes të disponueshëm të produktit në treg).

37. Inspektori vendos masën e ndalimit të furnizimit, ofrimit apo ekspozimit të produkteve apo grup-produkteve, pavarësisht nga kategoria e riskut edhe në këto raste:

a) Produkti nuk është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar për përputhshmërinë/sigurinë e produktit, sipas legjislacionit në fuqi;

b) Dokumentacioni i përcaktuar në shkronjën “a” nuk është i plotë, i vërtetë;

c) Produkti për të cilin kërkohet të tregtohet së bashku me udhëzimet për përdorim dhe/apo për mirëmbajtje, nuk shoqërohet me to, apo informacioni nuk është i plotë dhe në gjuhën shqipe;

d) Produkti për të cilin parashikohet markimi i konformitetit nuk e përmban këtë markim ose markimi është vendosur në mënyrë të paligjshme.

38. Në rastin e parashikuar në paragrafët 35 dhe 36, masa urgjente e parashikuar, mund të shoqërohet edhe me masën e urdhërimit të operatorit ekonomik për lajmërimin e konsumatorit dhe/ose përdoruesit të fundit, për riskun përkatës, nëse produkti është bërë tashmë i disponueshëm në treg.

39. Lajmërimi sipas paragrafit 38 më sipër, përmban lajmërimin për rrezikun e mundshëm, si dhe lajmërimin për mospërdorimin e produktit deri në një lajmërim të dytë. Lajmërimi bëhet nga operatori përgjegjës nën mbikëqyrjen e strukturës përgjegjëse.

40. Në rastin e produktit/instalimit në përdorim /shërbim, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm apo rezulton qartësi se përdorimi i produktit paraqet risk mesatar, të lartë apo serioz, inspektori vendos si masë urgjente ndalimin e përkohshëm të funksionimit apo përdorimit të produktit/instalimit.

41. Inspektori vendos masën e parashikuar në paragrafin 40 më sipër, pavarësisht nga kategoria e riskut edhe në këto raste:

a) Produkti/instalimi në shërbim/përdorim është i parëgjistruar sipas kërkesës së ligjit;

b) Produkti/instalimi në shërbim/përdorim nuk i është nënshtruar inspektimit periodik sipas ligjit për periudhën përkatëse;

c) Mungon dokumentacioni për inspektimin periodik të vlefshëm për periudhën përkatëse;

d) dokumentacioni apo shënimi i inspektimit periodik të vlefshëm për periudhën përkatëse është i pavërtetë.

42. Nëse produkti/instalimi në përdorim/shërbim, dyshohet se mund të paraqesë rrezik të ulët dhe vetëm në kushte të caktuara përdorimi, struktura përgjegjëse mund të vendosë, si masë urgjente vënien e paralajmërimeve të nevojshme për parandalimin apo minimizim e rrezikut.

VIII. Përfundimi i hetimit administrativ

43. Me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar në përputhje me ligjin, inspektori/inspektorët kryejnë një hetim të plotë administrativ.

44. Hetimi administrativ përfshin, nëse është e nevojshme, kryerjen e kontrollit laboratorik dhe shqyrtimin e dokumentacionit teknik dhe atij shoqëruar të produktit.

45. Gjatë hetimit, struktura përgjegjëse komunikon sa herë është e nevojshme me operatorin ekonomik përgjegjës. Komunikimi me operatorin ekonomik përgjegjës sigurohet në çdo formë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

46. Struktura e mbikëqyrjes së tregut mund t'i kërkojë operatorit përgjegjës ekonomik, dosjen /dokumentet teknike të produktit, pjesë apo përmbledhje të caktuara të tyre. Nëse është e nevojshme, dokumentacioni kërkohet i përkthyer në shqip.

IX. Vendimi përfundimtar

47. Vendimi përfundimtar merret sipas procedurave dhe brenda afateve të parashikuara në ligjin për inspektimin.

48. Vendimi përfundimtar merret nga inspektori /inspektorët që kanë kryer inspektimin pas marrjes së mendimit të Komisionit të Menaxhimit të Riskut, të krijuar sipas seksionit XXI më poshtë të këtij urdhri.

49. Vendimi përfundimtar merret në bazë të rezultateve të "vlerësimit përfundimtar të riskut", bazuar në një hetim të plotë administrativ, duke u mbështetur në gjetjet e inspektimit, verifikimin e dokumenteve përkatëse

(në mënyrë të veçantë të dosjes teknike) dhe rezultatet e kontrollit laboratorik të mostrave, nëse është rasti.

50. Vendimi përfundimtar merret vetëm pasi i është dhënë mundësia e shprehjes operatorit përgjegjës sipas ligjit. Komunikimi me operatorin përgjegjës sigurohet në çdo formë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

51. Në përfundim të hetimit administrativ sipas rregullave të parashikuara në këtë seksion, inspektori përgjegjës, në bazë të kategorisë të riskut të identifikuar, mund të vendosë marrjen e njëres apo më shumë nga masat e parashikuara në seksionet X deri XVII më poshtë të këtij urdhri.

X. Paralajmërimi zyrtar

52. Paralajmërimi zyrtar është masa më pak e rreptë që mund të vendosë të marrë struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

53. Nëse në përfundim të hetimit administrativ, vlerësohet se produkti është i sigurt, por janë konstatuar shkelje të vogla të kërkesave ligjore që nuk ndikojnë në sigurinë e tij në asnjë rrethanë, me vendim përfundimtar inspektori vendos, marrjen e masës së paralajmërimit. Paralajmërimi shoqërohet me urdhërimin për ndreqjen e shkeljeve, brenda një afati të caktuar dhe të arsyeshëm të përcaktuar nga inspektori.

54. Shkelje të vogla të kërkesave ligjore, që nuk ndikojnë në sigurinë e produktit, konsiderohen kryesisht, por jo vetëm: mangësi në etiketimin lidhur me të dhënat e produktit, të të dhënave të prodhuesit, përfaqësuesit të autorizuar apo importuesit, paqartësi në udhëzimet e përdorimit apo mirëmbajtjes etj.

55. Operatori ekonomik përgjegjës, që ka marrë paralajmërim, detyrohet të korrigjojë mangësitë brenda afatit të përcaktuar dhe përpara sesa të bëhen dërgesa të mëtejshme të produktit.

56. Me përfundimin e afatit, struktura përgjegjëse duhet të verifikojë nëse mangësitë janë korrigjuar vërtet.

XI. Marrja e masave të posaçme të sigurisë

57. Në rastet që vlerësohet se produkti është i sigurt, por ai mund të paraqesë një shkallë rreziku të bartur me përdorimin e produktit në kushte të caktuara, për përdorues të caktuar apo për shkak të kushteve të tregimit, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut mund të vendosë detyrimin e operatorit ekonomik përgjegjës:

a) të vendosë shënimin përkatës e të përshtatshëm në produkt për paralajmërim, të formuluar në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, për risqet që mund të paraqesë;

b) të bëjë tregtimin e tij, në kushte të përcaktuara nga struktura e mbikëqyrjes së tregut;

c) bëjnë paralajmërimet personave të caktuar, në formën e përshtatshme, përfshirë edhe publikimin e paralajmërimeve të veçanta.

58. Operatori ekonomik përgjegjës, që ka marrë paralajmërim, detyrohet të plotësojë detyrimet brenda afatit të përcaktuar.

59. Me përfundimin e afatit, struktura përgjegjëse duhet të verifikojë korrigjimin e mangësive.

XII. Ndalimi i përkohshëm i tregtimit

60. Në rastet kur vlerësohet se produkti paraqet një rrezik të çfarëdo kategorie, duke mos qenë në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë apo megjithëse në përputhje me këto kërkesa, është i rrezikshëm dhe mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjera publike, dhe kur vlerësohet se rreziku mund të shmanget, brenda një afati të arsyeshëm nëpërmjet modifikimit të produktit, struktura përgjegjëse vendos masën e ndalimit të përkohshëm të tregtimit deri në eliminimin e rrezikut.

61. Produkti, tregtimi i të cilit është ndaluar nuk mund të tregtohet dhe/apo të importohet në territorin e vendit deri në shmangien e rrezikut.

62. Produkti i modifikuar mund të tregtohet dhe/apo importohet vetëm pas miratimit me shkrim të strukturës përgjegjëse, pas një inspektimi të ri që vërteton shmangien e rrezikut.

XIII. Ndalimi i përhershëm i tregtimit

63. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, vendos ndalimin e përhershëm të tregtimit në këto raste:

a) Produkti nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë apo megjithëse në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë, është i rrezikshëm dhe mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjera publike; dhe

b) Rreziku që paraqet produkti, nuk është e mundur të shmanget, brenda një afati të arsyeshëm nëpërmjet modifikimit të tij, apo ky i fundit nuk paraqet garanci të mjaftueshme për modifikimin e përshtatshëm, të produktit.

64. Produkti, tregtimi i të cilit është ndaluar nuk mund të tregtohet apo të importohet në territorin e vendit.

65. Ndalimi i përhershëm i tregtimit vendoset nga struktura përgjegjëse, edhe në këto raste:

a) e njëjta masë është marrë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ku është tregtuar produkti;

b) prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm ose nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë.

XIV. Tërheqja e produktit nga tregu:

66. Nëse produkti që rezulton i rrezikshëm, gjendet tashmë në treg, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përveç “ndalimit të tregtimit” vendos edhe masën “tërheqje nga tregu” të produktit.

67. Masa e “tërheqjes nga tregu” merret, nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, në rastet kur veçoritë e rrezikshme të produktit nuk konsiderohen, të jenë në atë shkallë që të kërkohej kthimi mbrapsht i tij nga konsumatorët, ose kur produkti nuk ka shkuar ende te konsumatorit.

68. Tërheqja nga tregu, në varësi të gjendjes së produktit në zinxhirin e shpërndarjes mund të jetë e këtyre formave:

a) tërheqja nga shpërndarësit;

b) tërheqja nga i gjithë zinxhiri i tregtimit;

69. Struktura përgjegjëse vendos se tërheqja është e mjaftueshme duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së produktit në kuptimin e përdorimit të tij, si dhe numrin e produkteve të shitura. Në këto raste, operatorët ekonomikë janë të lirë, ta shtrijnë këtë masë deri në kthimin mbrapsht të produktit nga të gjithë konsumatorët. Procesi i tërheqjes nga tregu mund të përfshijë një shkresë nga fabrikuesi/importuesi për tregtarët me pakicë, ku njoftohet për tërheqjen nga tregu dhe udhëzohen për mënyrën dhe organizimin e tërheqjes së produktit, si dhe trajtimin e tij për këtë qëllim.

XV. Kthimi mbrapsht i produktit nga konsumatorët

70. Nëse produkti që rezulton me risk serioz gjendet në treg, apo nëse produkti rezulton me çfarëdo kategori tjetër risku dhe ka arritur te konsumatori apo përdoruesi i fundit, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, përveç ndalimit të tregtimit vendos edhe masën e “kthimit mbrapsht të produktit nga konsumatori”.

71. Me urdhërimin e kthimit mbrapsht të produktit, operatori përgjegjës duhet të kryejë sa më shpejt të jetë e mundur, kthimin mbrapsht të çdo produkti të shitur nga konsumatori apo përdoruesi final.

72. Kthimi mbrapsht i produktit nga operatori përkatës përgjegjës bëhet nën mbikëqyrjen e strukturës përgjegjëse. Nëse është e nevojshme apo i kërkohej, struktura përgjegjëse bashkërendon veprimtarinë e kthimit të produktit me prodhuesit dhe shpërndarësit.

73. Kur masat e marra nga operatori ekonomik nuk janë të mjaftueshme, apo çdo rast tjetër të nevojshëm, struktura përgjegjëse organizon drejtpërdrejt kthimin mbrapsht të produktit.

Kthimi mbrapsht i produktit sipas paragrafit 73 më sipër, kryhet me shpenzimet e operatorit ekonomik përgjegjës. Struktura përgjegjëse njofton operatorin ekonomik për shumën përkatëse që detyrohet të paguajë.

XVI. Lajmërimi publik i konsumatorit

74. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, vendos urdhërimin e lajmërimit publik të konsumatorit, sa herë që një masë e tillë është e nevojshme për shmangien e rrezikut. Në mënyrë të veçantë, lajmërimi publik i konsumatorit, vendoset së bashku me masën e tërheqjes nga tregu apo kthimit mbrapsht të produktit nga konsumatori në rastet e mëposhtme:

a) kur produkti duhet të tërhiqet dhe operatori ekonomik, njëj vetëm një pjesë të konsumatorëve;

b) kur produkti duhet të largohet nga tregu dhe parashikohet se ky produkt është kaq i lirë sa që, ka të ngjarë, që vetë përdoruesi ta heqë atë.

75. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, vendos masën e lajmërimit publik të konsumatorit, edhe veçmas (pra, jo bashkë me masën e tërheqjes nga tregu apo kthimit të produktit nga konsumatori), nëse problemet e mundshme të sigurisë, karakteristike të një rreziku të ulët, mund të zgjidhen plotësisht duke paralajmëruar konsumatorët dhe pa kërkuar modifikimin e produktit.

76. Lajmërimi publik bëhet nga operatori ekonomik përgjegjës dhe mbikëqyret nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

77. Struktura përgjegjëse mund të vendosë të kryejë drejtpërdrejt lajmërimin publik të konsumatorit në këto raste:

a) Operatori ekonomik përgjegjës nuk mund të identifikohet;

b) Masat e mara nga operatori ekonomik përgjegjës nuk janë të plota, të shpejta apo të përshtatshme;

c) rreziku që paraqet produkti, është aq i madh sa konsumatorët mund të dëmtohen rëndë nëse nuk e marrin shpejt lajmërimin përkatës;

d) Rreziku është i pranishëm për një klasë të tërë produktesh e jo vetëm për një artikull/model të caktuar.

78. Lajmërimi publik i konsumatorit duhet të jetë i plotë, i qartë, dhe të kryhet me mjete të përshtatshme dhe efektive publikimi. Mjete të përshtatshme përfshijnë njoftimin në median e shkruar dhe atë vizive.

79. Lajmërimin publik, drejtpërdrejt, sipas paragrafit 78, përveç rastit kur operatori nuk mund të identifikohet, kryhet me shpenzimet e operatorit përgjegjës. Shuma përkatëse që detyrohet të paguajë, operatori, i njoftohet me akt të veçantë nga struktura përgjegjëse.

XVII. Shkatërrimi i produktit

80. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut vendos shkatërrimin e produkteve kur ato janë kthyer mbrapsht prej konsumatorëve dhe:

a) Produkti paraqet një rrezik të tillë për sigurinë e konsumatorëve sa që duhet shkatërruar; apo

b) Është i pamundur nga operatori ekonomik përgjegjës, modifikimi apo rieksporimi i produktit .

81. Përpara marrjes së masës për shkatërrimin e produktit, struktura përgjegjëse duhet të marrë parasysh ndikimin ekonomik mbi operatorin ekonomik dhe të konsultohet, në mënyrë që të sigurojë që modifikimi apo rieksporimi i produktit nuk është i mundur.

82. Shkatërrimi i produktit bëhet nga struktura e posaçme, me shpenzimet e operatorit ekonomik përgjegjës dhe sipas proceduarve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Shuma përkatëse që detyrohet të paguajë operatori, i njoftohet me akt të veçantë të strukturës përgjegjëse.

XVIII. Listë kontrollet

83. Secila strukturë e mbikëqyrjes së tregut harton listë-kontrollet për secilin nga produktet/grup-produktet nën kompetencën e saj.

84. Listë-kontrolli hartohet nga struktura përkatëse e mbikëqyrjes së tregut dhe miratohet nga kryeinspektori, pas marrjes së mendimit këshillimor të Inspektoratit Qendror dhe ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

85. Listë-kontrolli përmban elementet thelbësore të kontrollit dhe testet e nevojshme lidhur me sigurinë e një produkti apo grupi produktesh të përcaktuara. Elementet thelbësore janë: dokumentacioni, markime, shënime apo veti/karakteristika kryesore të produktit/grup-produkteve që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e tyre).

86. Çdo listë-kontroll përmban të paktën këto elemente të detyrueshme kontrolli:

a) Markimin e produktit;

b) Emrin e prodhuesit në produkt, dhe/ose sipas rastit, përfaqësuesit të autorizuar apo importuesit;

c) Deklaratën e konformitetit/dokument tjetër ekuivalent sipas legjislacionit;

d) Dokumentet shoqëruese të produktit (udhëzimet e përdorimit dhe/ose mirëmbajtjes);

e) Kontrollimin për anë të mprehtë në vendet ku përdoruesit e prekin produktin (A ka produkti, në pjesën që preket ashkla apo të tjera si këto? A duket se produkti ka nivel të lartë rrezikshmërie për t'u djegur?);

f) Kontrollimin për nxehe shumë të produktit në vendet ku e prekin përdoruesit (qëllimisht ose jo qëllimisht).

87. Përveç elementeve të përcaktuara në paragrafin 86 më sipër, listë-kontrolli për çdo produkt/grup-produkte përmban elementet e tjera thelbësore specifike për produktin/grup-produktin përkatës.

a) Elementet specifike thelbësore dhe testet specifike të kontrollit përcaktohen në bazë të kërkesave të parashikuara në standardet e harmonizuara shqiptare dhe legjislacionin e përgjithshme apo të veçantë në fuqi për produktin.

XIX. Procedura e marrjes, trajtimit dhe kontrollit laboratorik të mostrës

88. Përveçse kur numri i mostrave parashikohet shprehimisht në standardin apo rregullin teknik përkatës, si rregull për kontroll laboratorik merren tre mostra identike të produktit pjesë e së njëjtës parti.

89. Për mostrat e marra, inspektori i lëshon subjektit të inspektimit një "vërtetim mostre". Vërtetimi përmban të dhënat e përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

90. Vërtetimi i marrjes të mostrës përpilohet 1 në origjinal dhe 2 kopje identike. Origjinali i vërtetimit dhe një nga kopjet mbahet nga struktura mbikëqyrëse dhe është pjesë përbërëse e dosjes së procedimit përkatës. Kopja e fundit i njoftohet prodhuesit/importuesit/tregtuesit me pakicë në mjediset e tij.

91. Vendimi procedural për marrjen e mostrave, pasqyrohet, gjithashtu, në procesverbalin e inspektimit.

92. Produkti i marrë mostër, ruhet në ambalazhin fillestar apo ambalazhohet në mënyrë të tillë që të mos cenohet integriteti dhe siguria e produktit. Kur produktet

nuk janë të reja (domethënë të marra drejtpërdrejt nga zinxhiri i shitjeve) dhe sidomos kur ato hetohen si pjesë e një çështjeje gjyqësore, do t'i kushtohet vëmendje e posaçme ambalazhimit të produktit në mënyrë të tillë që vetë produkti të mos ndryshojë.

93. Tre mostrat e marra ndahen në mënyrë rastësore në:

- a) mostra kryesore (K) për kontroll laboratorik;
- b) mostra rezerve (A), që mbahet nëse mostra e parë del se ka mangësi të rrezikshme dhe
- c) mostra e referencës (R), që mbahet, për rastet e mosmarrëveshjeve gjyqësore me operatorin.

94. Secila nga tre mostrat e marra etiketohet në mënyrë të përshtatshme. Etiketimi përmban një numër unik identifikimi të mostrës dhe kategorisë së mostrës (mostra kryesore (K), mostra rezervë (A), mostra e referencës (R)).

95. Numri unik i identifikimit është pjesë e një regjistri të mostrave të krijuar nga struktura përgjegjëse. Në regjistrin përkatës numri unik i identifikimit lidhet me numrin e procedimit administrativ, që është numri i dosjes së procedimit në fjalë.

96. Mostra kryesore (K) dërgohet në laborator, ndërsa dy mostrat e tjera, të shoqëruara me kohen e dytë të vërtetimit, ruhen në ambiente të përshtatshme për këtë qëllim në strukturën e mbikëqyrjes së tregut.

97. Mostra kryesore dërgohet në një laborator të akredituar sipas kësaj radhe preference:

- a) laboratorët e strukturës së mbikëqyrjes të tregut;
- b) laboratorë të tjerë shtetërore; apo
- c) laboratorë privatë të akredituar për këtë qëllim.

98. Gjatë kryerjes së testeve, laboratori mund të vendosë, gjithashtu, numrin e vet unik të identifikimit për produktin.

99. Laboratori përqendrohet vetëm në testimin e karakteristikave/vetive për të cilat produkti është ose jo në përputhje me standardet. Gjetjet përmbledhen në Raportin e Testimit, që mbahet në tri kopje. Një nga kopjet mbahet në laborator, ndërsa tjetra bëhet pjesë e dosjes të procedimit përkatës.

100. Raporti i Testimit përshkruan vetitë/karakteristikat për të cilat produkti është ose jo në përputhje me kërkesat e sigurisë. Raporti i testimit nuk vlerëson nëse këto mospërputhje janë të rrezikshme apo jo.

XX. Vlerësimi i riskut

101. Inspektori/inspektorët përgjegjës kryejnë vlerësimin paraprak apo përfundimtar të riskut për çdo veti/karakteristikë të produktit që lidhet me sigurinë e tij sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës. Vlerësimi i riskut përfshin këta komponentë:

- a) rëndësinë/gravitetin e dëmit;
- b) probabilitetin e prodhimit të dëmit.

102. Në bazë të rezultatit për çdo veti/karakteristikë, hartohet vlerësimi i përgjithshëm i riskut të produktit sipas njëres prej këtyre kategorive:

- a) risk i ulët;
- b) risk i mesëm;
- c) risk i lartë;
- d) risk serioz.

103. Vlerësimi i riskut për çdo veti/karakteristikë dhe vlerësimi i përgjithshëm risku për produktin kryhet bazuar në udhëzimin e ministrit nr. 177, datë 26.12.2013 dhe sipas aneksit 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

XXI. Komisioni i Menaxhimit të Riskut

104. Në çdo strukturë të mbikëqyrjes së tregut funksion Komisioni i Menaxhimit të Riskut. Komisioni i Menaxhimit të Riskut jep mendim këshillimor për masat e nevojshme që duhen marrë me vendim përfundimtar. Me kërkesë dhe nëse është e mundur Komisioni i Menaxhimit të Riskut jep mendim këshillimor edhe për masat urgjente.

105. Komisioni i Menaxhimit të Riskut është komision *ad hoc* që krijohet nga titullari strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut. Komisioni *ad hoc* përbëhet nga titullari i strukturës përgjegjëse dhe nëpunës të njëjësive organizative përbërëse të strukturës përgjegjëse.

106. Komisioni i Menaxhimit të Riskut ka një numër tek anëtarësh, jo më të vogël se pesë.

Aneksi 1: Vërtetimi i marrjes së mostrës

Nr. ref. i mostrës _____ Data: _____ Emri / Vendndodhja e pikës së tregimit: _____ Përshkrimi i produktit: _____ Importuar nga (specifiko vendin): _____ Prodhuar në vend: _____ Marka(t) Emërtimi (et)/Emri i prodhuesit: _____ Peshë/Sasia e mostrave të marra: _____ Loti/partia nr.: _____ Nënshkrimi i zotëruesit/ Emri me shkronja të mëdha të zeza: _____ _____ Numri i telefonit: _____
--

Nënshkrimi i inspektorit të mbikëqyrjes së tregut / Emri me shkronja të mëdha të zeza:

[Drejtuar dhe për llogari të strukturës së mbikëqyrjes së tregut]

Mostra e kthyer më: _____

Nënshkrimi i pronarit për pranimin: _____

Aneks nr. 2. Formulari i vlerësimit të riskut

FORMULARI I VLERËSIMIT TË RISKUT		
Data:	Produkti:	Inspektori:

A. Vlerësimi i shkallës së dëmtimit

Niveli 1: Dëmtimi ose pasoja që pas ndihmës së parë, normalisht jo me një mjek, nuk dëmton në thelb aftësitë funksionale të individit ose nuk shkakton dhimbje të tepërt; në këto raste pasojat janë zakonisht krejtësisht të kthyeshme	Niveli 2: Dëmtimi ose pasoja për të cilën është e nevojshme vizita në institucionet shëndetësore, përfshirë Shërbimin e Urgjencës, por për të cilën përgjithësisht nuk nevojitet shtrimi në spital. Në këto raste mund të preken aftësitë funksionale për një periudhë të kufizuar, por jo më shumë se 6 muaj, dhe shërimi është pak a shumë i plotë.	Niveli 3: Dëmtimi ose pasoja që normalisht kërkon shtrimin në spital dhe ndikon në aftësitë funksionale të individit për më shumë se 6 muaj ose çon në humbje të përhershme të funksionit	Niveli 4: Dëmtimi ose pasoja që është ose mund të jetë fatale, duke përfshirë mosfunksionimin etrurit; pasoja që ndikojnë në riprodhimin ose pasardhësin, humbje të rënda të gjymtyrëve dhe/ose funksionit, që çon në më shumë se rreth 10% të kufizimit të aftësisë
<2% paaftësim, zakonisht e kthyeshme e që nuk kërkon kurim në spital	2 – 10% paaftësim, zakonisht i pakthyeshem e që kërkon kurim në spital	>10% paaftësim	>20% paaftësim, zakonisht i pakthyeshem
			Vdekje
Prerje të vogla	Prerje të rënda	Prerje e organeve të brendshme	Dëmtim serioz i organeve të brendshme
Fraktura të lehta	Humbje e gishtit të dorës apo të këmbës	Thyerje e kockës	Humbje e gjymtyrëve
	Dëmtim i shikimit	Humbje e pjeshme e shikimit	Humbje e shikimit
Nxjerrje nga vendi e gjymtyrëve	Dëmtim i dëgjimit	Humbje e pjeshme e dëgjimit	Humbje e dëgjimit
Djegje të lehta	Djegje mesatare	2°, 16-35 % e sipërfaqes së trupit, ose 3°, deri në 35 % të sipërfaqes së trupit	2° ose 3°, > 35 % e sipërfaqes së trupit
		Djegje nga thithja	Djegje nga thithja që kërkon asistim të frymëmarrjes
Ndrydhje	Paaftësi mesatare	Këputje e muskulit	Paaftësi e rëndë e përhershme

B) Probabiliteti i përgjithshëm i dëmtimit të shëndetit/sigurisë

Probabiliteti i dëmtimit të produktit	
Pothuajse e sigurt, pritet të ndodhë	> 50%
Tërësisht e mundur	> 1/10
E pazakontë, por e mundur të ndodhë	> 1/100
Pak e mundur të ndodhë	> 1/1 000
E imagjinueshme, por shumë e vështirë të ndodhë	> 1/10 000
Praktikisht e pamundur të ndodhë	> 1/ 100 000
E pamundur të ndodhë	> 1/1 000 000
Virtualisht e pamundur të ndodhë	< 1/1 000 000

C) Vlerësimi i përgjithshëm i riskut

Probabiliteti i dëmtimit të produktit		Shkalla e dëmtimit			
Pothuajse e sigurt, pritet të ndodhë	> 50%	H	S	S	S
Tërësisht e mundur	> 1/10	M	S	S	S
E pazakontë por e mundur të ndodhë	> 1/100	M	S	S	S
Pak e mundur të ndodhë	> 1/1 000	L	H	S	S
E imagjinueshme, por shumë e vështirë të ndodhë	> 1/10 000	L	M	H	S
Praktikisht e pamundur të ndodhë	> 1/ 100 000	L	L	M	H
E pamundur të ndodhë	> 1/1 000 000	L	L	L	M
Virtualisht e pamundur të ndodhë	< 1/1 000 000	L	L	L	L

S – risk serioz

H – risk i lartë

M – risk mesatar

L – risk i ulët

URDHËR

Nr. 350, datë 15.7.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LAKTOPROTEINAT E CAKTUARA, KAZEINAT DHE KAZEINATET, TË DESTINUARA PËR KONSUM NJERËZOR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 23, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për laktoproteinat e caktuara, kazeinat dhe kazeinatet, të destinuara për konsum njerëzor”, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

RREGULLORE

PËR LAKTOPROTEINAT E CAKTUARA, KAZEINAT DHE KAZEINATET, TË DESTINUARA PËR KONSUM NJERËZOR

1. Kjo rregullore përcakton laktoproteinat, kazeinat dhe kazeinatet, të destinuara për konsum njerëzor, siç përcaktohet në anekset I dhe II të kësaj rregullore.

2. Në kuptim të kësaj rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: “Kazeina”, janë proteinat kryesore përbërëse të qumështit, të lara, të thara, të patretshme në ujë dhe të marra nga qumështi i skremuar me precipitim:

- a) me anë të shtimit të acidit; ose
- b) me anë të acidifikimit mikrobik; ose
- c) duke përdorur mullëz; ose

d) duke përdorur enzima të tjera qumështi të koagulluar, pa cenuar mundësinë e përdorimit paraprak të proceseve të këmbimit të jonit dhe proceseve të përqendrimit. “Kazeinate” janë produkte të marra nga tharja e kazeinave të trajtuar me agjentë neutralizues; “Qumësht i skremuar”, është qumështi i një ose më shumë lopëve pa shtesa të tjera, por me reduktim të përmbajtjes së yndyrës.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e përcaktuara në anekset bashkëlidhur kësaj rregullore mund të tregtohen vetëm nëse ato janë në përputhje me

përcaktimet dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore dhe anekset e saj.

4. Emrat e përcaktuara në anekset I dhe II do të ruhen për karakterizimin e produkteve të përcaktuara dhe do të përdoren për të emërtuar ato produkte nga ana tregtare.

5. Përveçsa përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1344, datë 10.10.2008, për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore”, dhe etiketimin e produkteve ushqimore jo të destinuar për konsumatorin përfundimtar, të dhënat e detyrueshme për t’u shënuar në ambalazh, kontejnerë ose etiketat e produkteve të përcaktuara në anekset e kësaj rregullore, veçoritë e të cilave janë të dukshme qartë, lehtësisht të lexueshme dhe të pashlyeshme në karaktere, do të jenë si më poshtë:

a) Emri i rezervuar për këto produkte në përputhje me pikën 4 më sipër, në rastin e kazeinateve me një tregues për kujdesin ose paralajmërim;

b) Në rastin e produkteve të tregtuara si përzierje: i) fjala “përzierje e ...” do shoqërohet nga emrat e produkteve të ndryshëm, të cilët krijojnë përzierje në rend zbritës sipas peshës; ii) një tregues për kujdesin ose paralajmërimin në rastin e kazeinave ose kazeinateve; iii) përmbajtja e proteinave në rastin e përzierjeve që përmbajnë kazeinate.

c) Sasia neto e shprehur në njësitë e masës: kilogram ose gram;

d) Emri i biznesit dhe adresa e prodhuesit, paketuesit ose shitësit;

Në rastin e prodhimit kombëtar, të përmenden detaje të ndërmarrjes së prodhimit apo paketimit;

e) Në rastin e produkteve të importuara nga vendet e treta, emrin e vendit të origjinës;

f) Data e prodhimit ose disa shënime me të cilat ngarkesa mund të identifikohet.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të ndalojë tregtimin në vend të kazeinave dhe kazeinateve të ngrënshme, nëse të dhënat e përcaktuara në paragrafin 5 (a), (b), (e) dhe (f), nuk paraqiten në një gjuhë tëkuptueshme lehtë nga konsumatori, përveç rasteve kur një informacion i tillë është dhënë me mënyra të tjera. Kjo rregullore nuk përjashton paraqitjen e hollësishme në disa gjuhë.

ANEKSI I

KAZEINAT USHQIMORE (TË NGRËNSHME)

I. EMËRTIMET

a) “Kazeinë ushqimore acide”, kazeina ushqimore e përftuar nga precipitimi i ndihmësve teknologjikë dhe kulturave bakteriale të përdorura, të listuara në seksionin II (d), të cilat janë në përputhje me standardet e përcaktuara në seksionin II.

b) “Kazeinë ushqimore me maja*”, kazeina ushqimore e përftuar nga precipitimi i ndihmësve teknologjikë të përdorur të listuar në seksionin III (d), të

cilat përputhen me standardet e përcaktuara në seksionin III.

* (majaja për koagulimin e qumështit (mpiksjes))

II. STANDARDET E ZBATUESHME

PËR “KAZEINAT USHQIMORE ACIDE”

a) Elementet kryesore të përbërjes	
1. Përmbajtja maksimale e lagështisë	10,0% ndaj peshës
2. Përmbajtja minimale e proteinës së qumështit llogaritur mbi ekstraktin e tharë	90% ndaj peshës
nga e cila përmbajtja minimale e kazeinës	95% daj peshës
3. Përmbajtja maksimale e yndyrës në qumësht llogaritur mbi ekstraktin e tharë	2,25% ndaj peshës
4. Aciditeti titratable maksimal, shprehur në ml hidroksid natriumi decinormal solucion për g	0,27 për g
5. Përmbajtja maksimale e hirit (përfshirë P2O5)	2,5% ndaj peshës
6. Përmbajtja maksimale e anhydrous lactose	1% ndaj peshës
7. Përmbajtja maksimale e sedimentit (grimcat e djegura)	22,5 mg në 25 g

b) Ndotësit

Përmbajtja maksimale të jetë 1 mg / kg

c) Papastërtitë

Lëndë të huaja (të tilla, si: grimca druri apo metali, qime ose pjesë të insekteve) zero në 25 g.

d) Ndhimësit e padëmshëm teknologjikë dhe kulturat bakteriale të përshtatshme për konsum njerëzor:

i) acid laktik (E 270)

- acid klorhidrik;
- acid sulfurik;
- acid citrik (E 330);
- acid acetik (E 260);
- acid ortofosforik.

ii) - hirrë

- Kulturat bakteriale për prodhimin e acidit laktik

e) Karakteristikat organoleptike

1. Aroma: Nuk ka aromë të huaj.
2. Pamja e jashtme:

Ngjyra e bardhë, duke filluar nga e bardhë e lehtë, produkti nuk duhet të përmbajë asnjë kokërr që nuk copëtohet nën presion të lehtë.

III. STANDARDET E ZBATUESHME PËR “KAZEINAT USHQIMORE ME MAJA”

a) Elementet kryesore të përbërjes	
1. Përmbajtja maksimale e lagështisë	10,0% m/m
2. Përmbajtja minimale e proteinës së qumështit llogaritur mbi ekstraktin e tharë	84% ndaj peshës
nga e cila përmbajtja minimale e kazeinës	95% ndaj peshës
3. Përmbajtja maksimale e yndyrës në qumësht llogaritur mbi ekstraktin e tharë	2% ndaj peshës

- | | |
|--|------------------|
| 4. Përmbajtja minimale e hirit (përfshirë P2O5) | 7,5% ndaj peshës |
| 5. Përmbajtja maksimale e anhydrous lactose | 1% ndaj peshës |
| 6. Përmbajtja maksimale e sedimentit (grimcat e djegura) | 22,5 mg në 25 g |

b) Ndotësit

Përmbajtja maksimale të jetë 1 mg / kg

c) Papastërtitë

Lëndë të huaja (të tilla, si: grimca druri apo metali, qime ose pjesë të insekteve) zero në 25 g;

d) Ndihmësit e padëmshëm teknologjikë të përshtatshëm për konsum njerëzor.

- Fara e djathit (majaja) të përmbushë kërkesat e legjislacionit në fuqi mbi enzimat ushqimore.

e) Karakteristikat organoleptike

1. Aroma: Nuk ka aromë të huaj.

2. Pamja e jashtme: Ngjyra e bardhë, duke filluar nga e bardhë e lehtë, produkti nuk duhet të përmbajë asnjë kokërr që nuk copëtohet nën presion të lehtë.

b) Ndotësit

Përmbajtja maksimale të jetë 1 mg / kg

c) Papastërtitë

Lëndë të huaja (të tilla, si: grimca druri apo metali, qime ose pjesë të insekteve) zero në 25 g.

d) Ndihmësit teknologjikë (neutralizimi jo i detyrueshëm dhe agjentët zbutës)

hydroxidët	}	nga	sodium
karbonatët		kalium	
fosfatët		kalcium	
citratët		amonium	
			magnez

e) Karakteristikat:

1. Aroma: Shije dhe aromë të huaj shumë të lehtë.

2. Pamja e jashtme: Ngjyra e bardhë duke filluar nga e bardhë e lehtë produkti nuk duhet të përmbajë asnjë kokërr që nuk copëtohet nën presion të lehtë.

3. Tretshmëria: Pothuajse tërësisht i tretshëm në ujë të distiluar, me përjashtim të kalciumit kazeinat.

ANEKSI II

KAZEINATET USHQIMORE (TË NGRËNSHME)

I. EMËRTIMET

“Kazeinatet ushqimore (të ngrënshe)”, kazeinatet e marra nga kazeinat ushqimore, duke përdorur agjentët neutralizues ushqimorë, të listuar në seksionin II (d) dhe në përputhje me standardet e përcaktuara në seksionin

II. STANDARDET E ZBATUESHME PËR KAZEINATET USHQIMORE

a) Elementet kryesore të përbërjes

- | | |
|---|-------------------|
| 1. Përmbajtja maksimale e lagështisë | 8 % ndaj peshës |
| 2. Përmbajtja minimale e kazeinës së proteinës së qumështit llogaritur mbi ekstraktin e tharë | 88 % ndaj peshës |
| 3. Përmbajtja maksimale e yndyrës në qumësht llogaritur mbi ekstraktin e tharë | 2.0 % ndaj peshës |
| 4. Vlera e pH | 6.0 - 8.0 |
| 5. Përmbajtja maksimale e anhydrous lactose | 1.0 % ndaj peshës |
| 6. Përmbajtja maksimale e sedimentit (grimcat e djegura) | 22,5 mg në 25 g |

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në vendimin nr. 853, datë 2.7.2014, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Rudin Arapi, i biri i Hakimit dhe i Lilianës, i datëlindjes 22.5.1976.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006